

**VENDIM**  
**Nr. 664, datë 12.11.2025**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES  
TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, dhe 25, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit “Lista e OKB-së”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar, bëhet një shtesë, me këtë përmbajtje:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*”, shtohet 1 (një) individ i renditur në shkronjën “a”, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për individët e shpallur anëtarë ose bashkëpunëtorë të organizatave ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**

**SHTESË NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË  
TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT  
 (“LISTA E OKB-së”)

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME  
ORGANIZATAT ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida***

**a) Shtesë në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*”;**

1. AHMAD: HUSSAIN: AL-SHARAA: ABU MOHAMMED: AL-JAWLANI

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Agjencinë e Inteligjencës Financiare.